

THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE PËR MONITORIM TË PROCESIT TË TENDERIMIT PËR STUDIMIN E FIZIBILITETIT TË OBJEKTIT TË PRESIDENCËS SË KOSOVËS

Në kuadër të përpjekjeve për të garantuar transparencë maksimale dhe pjesëmarrje qytetare në proceset publike, bazuar në kërkesën e Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, Platforma Civikos, fton organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në Kosovë të nominojnë përfaqësues për të monitoruar procesin e tenderimit për studimin e fizibilitetit të objektit të Presidencës si dhe në fazën tjetër edhe Projektin Ideor.

Qëllimi i angazhimit:

Të sigurohet monitorim i pavarur dhe gjithëpërfshirës gjatë të gjitha fazave të procesit të tenderit – përgatitja, shpallja, hapja dhe vlerësimi i ofertave.

Kriteret

Organizatat që nominojnë përfaqësues duhet të:

- Të jenë organizata të regjistruara në Republikën e Kosovës sipas Ligjit për liri të asociimit të Republikës së Kosovës.
- Të kenë fusheveprim në një ose më shumë nga këto fusha:
 - Monitorimi i institucioneve publike;
 - Transparenca dhe llogaridhënia institucionale;
 - Pjesëmarrja qytetare dhe përfshirja në vendimmarrje publike;
- Të kenë përvojë të dëshmuar në aktivitete të ngjashme monitorimi.

Personat e nominuar duhet:

- Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në sektorin e shoqërisë civile;
- Të kenë integritet të lartë profesional dhe etik;

OJQ-të aplikuese dhe personat e nominuar duhet të dëshmojnë aktivitetin e tyre në fushat specifike përmes dëshmime konkrete të aktiviteteve të ndërmarra nga ta përgjatë punës (raporte, publikime, lajme, linqe apo dëshmi të tjera të aktivitetit).

Për të nominuar një kandidat/e, OSHC-ja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. CV të kandidatit/es që organizata e nominon;
2. Certifikatën e regjistrimit të organizatës;
3. Dëshmi rreth misionit dhe përvojës së organizatës (jo më shumë se 1 faqe A4)
4. Dëshmitë tjera të aktivitetit në fushën përkatëse. Nëse dëshmia e aktivitetit specifik është e qasshme online, mjafton që të ofrohet linku përkatës.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: info@civikos.net. Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 12.08.2025

SHENIM: Kjo thirrje është e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Kosovë dhe nuk limitohet në anëtarësinë në Platformën CiviKos.

Procedura e votimit për anëtarët

Në rast se kemi më shumë se 1 kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës të CiviKos. Kandidatët që marrin më së shumti vota do të përzgjidhen.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.